



Comune di Cervia



Comune di Ravenna



Comune di Russi

PRINDERVE TE NXENESVE TE ARDHUR NGA VENDE TE TJERA

SI FUNKSIONON SHKOLLA NE ITALI



Informacionet e para per dhenien e miresearchjes femijeve tuaj

Questo opuscolo è tradotto in 7 lingue:
albanese, arabo, inglese, francese, russo
romeno, macedone

Testo in lingua albanese

MIRESERDHET NE RAVENNA DHE NE SHKOLLAT E SAJE

Ky liber i vogel na jep mundesine për t'ju dhene mireseardhjen dhe për t'ju ndihmuar të kuptoni si funksionon shkolla italiane. Edhe pse viti shkollor ka filluar, ju mund të regjistroni femijet tuaj. Të gjithë fëmijet kane të drejte të frekuentojne shkollen, edhe kur janë pa leje qendrimi në Itali
(ONU, *Conventa nderkombetare per te drejttat e femijeve, Art. 28*)

Sa vjet zgjat shkolla në Itali

Shkolla e detyrueshme(*) zgjat dhjete vjet:

- 5 vjet shkolla fillore (cikli i ulet)
- 3 vjet shkolla 8-vjeçare (cikli i larte)
- 2 vjet orientim per ciklin e dyte të shkolles se mesme

Çerdhe: nga 0 vjeç në 3 vjeç

Arsimi parashkollore: nga 3 vjeç në 6 vjeç

Cikli i ulet(*)	nga 6 vjeç në 11 vjeç
Cikli i larte(*)	nga 11 vjeç në 14 vjeç
Orientami 2- vjeçar per shkollen e mesme nga 14 vjeç në 16 vjeç	

Shkolla e mesme nga 16 vjeç ne 19 vjeç

Arsimi i detyrueshem është falas.

Në ciklin e ulet librat jepen falas; familjët duhet të blejne fletoret, lapsat dhe penat.

DOKUMENTACIONI QW DUHET PWR TU REGJISTRUAR NW SHKOLLW

- **çertifikatë lindjeje** (në se nuk e keni këtë dokument,mund të paraqisni pashaportën ose lejen e qendrimit në Itali -permesso di soggiorno-)
- **çertifikatë e vaksinimit** (do t'ju prenotohet një vizitë tek asistenca mjekësore që do të mund të çertifikoj gjëndjen e mirë shëndetësore të femijës tuaj dhe do te marrw masat për të kompletuar vaksinimet q mëund të mungojnë)
- **dokumentat e shkollës që fëmija ka ndjekur** (në se nuk keni këtë dokument prindi deklaron nën përgjegjësine e tij klasën dhe shkollën që fëmija ka ndjekur në vendin tuaj)

Njëkohësisht me regjistrimin mbushen edhe kërkesat për:

- zgjedhjen e tipit të shkollës që dëshironi të ndiqni
- nëse dëshironi të ndiqni mësimin e fesë katolike
- regjistrimin në mensën shkollore
- regjistrimi në aktivitetet që zhvillohen para dhe mbas orëve të zakonshme të mësimi
- regjistrimi në shërbimet e transportit shkollor_

ORARET

Në shumë shkolla prindërit mund të zgjedhin dy mundësi

- 1) 40 ore javore nga e hëna në të premte nga ora 8.30 deri në orën 16.30 me mensë shkollore
- 2) 27 ose 30 orë javore nga e hëna në të shtunë në të cilat nxënësit ndjekin orarin e mbasdites. Ditët në të cilat mësimi zhvillohet edhe mbasdite janë të përcaktuara nga çdo shkollë. Leksionet fillojnë në orën 8.30 (disa shkolla fillojnë në orën 8.00). Është e rëndësishme të jeni të përpiktë.

Kërkoni të mësoni sa më shpejtë oraret e klasës të fëmijës tuaj_

SI MUND TË REGJISTROHEN FËMIJËT NË MENSËN SHKOLLORE

Gati çdo shkollë ofron shërbimin e mensës. Prindërit paguajnë një shifër për këtë shërbim.

Për arsye shëndetësore ose feje keni mundësinë të kërkoni një dietë të veçantë në momentin kur bëni kërkesën për këtë shërbim.

NË QOFTË SE PRINDËRIT FILLOJNË TEPËR HERËT PUNËN APO MBAROJNË TEPËR VONË

Për të ndihmuar familjet që kanë orare pune jo të zakonshme, disa shkolla organizojnë aktivitete para orarit shkollor (nga ora 7.30 deri në orën 8.30) dhe mbas këtij orari (nga ora 16.30 deri në orën 17.00)_

MËSIMI I FESË KATOLIKE OSE NJË AKTIVITETI TJETËR

Në shkollën italiane parashikohet mësimi fakultativ i fesë katolike. Për këtë arsye në momentin e regjistrimit në shkollë prindi duhet të deklarojë nëse dëshiron që fëmija të përfitojë:

- Mësimin e fesë katolike
- Aktivitete grupore mësimore dhe formative
- Aktivitete individuale për mësim dhe thellim të mësimave me ndihmën e një mësuesi
- Dalje nga shkolla

NË QOFTË SE BANONI LARG NGA SHKOLLA

Keni mundësinë të kërkonte transportin shkollor me autobus të vogël për fëmijet duke paguajtur një shifër për çdo vit.

KALENDARI SHKOLLOR

Shkolla vazhdon rreth nëntë muaj në vit.

Fillon në mes të shtatorit dhe mbaron në gjysmën e dytë të qershorit
Ka dy periudha pushimesh:

1) Dy javë për krishtlindjet (zakonisht nga data 23 dhjetor deri në 6 janar)

2) Rreth një jave për pashkët (në mars ose në prill)

Për këto gjëra shkolla do t'ju informojë gjithmonë nëpërmjet një mesazhi të shkruar nga mësuesit në ditarin e fëmijës tuaj

Është shumë e rëndësishme që të kontrolloni gjithmonë ditarin

MUNGESAT NE SHKOLLE

çdo herë që fëmija nuk shkon në shkollë prindërit duhet ta justifikojnë arsyen e mungesës.

Në rast sëmundjeje që e mban fëmijën në shtëpi për më shumë se gjashtë ditë, për tu kthyer në shkollë do të keni nevojë për certifikatën mjekësore që deklaron që fëmija është shëruar!

C'FARË MËSOJNË FËMIJËT NË SHKOLLË

-Gjuhën italiane

-Një gjuhë të huaj (në shkollën fillore nga viti i parë;në tetë vjeçare mund edhe të shtohet një gjuhë tjetër)

-Matematikë

-Shkencë dhe teknologji (edukim shkencor,informatikë)

-Histori

-Gjeografi

-Studime sociale

-Vizatim (edukim artistik,edukim për imazhet)

-Gjymnastikë (edukim fizik)

-Muzikë

SI VLERËSOHEN RISULTATET SHKOLLORE

çdo vit shkollor është i ndarë në dy pjesë (2 semestra).

Në janar dhe në qershor mësuesit bëjnë një vlerësim të rezultateve shkollore të fëmijes tuaj dhe përgatisin një "skedë vlerësimi" që do ti dorëzohet familjes

MBLEDHJET ME PRINDËRIT

Gjatë vitit shkollor organizohen disa mbledhje me prindërit.Mbledhjet me prindërit janë të rëndësishme për të folur bashkë me mësuesit dhe të kuptoni programet e studimit të fëmijëve tuaj.

Prindërit dhe mësuesit mund të bashkëpunojnë për edukimin e fëmijëve dhe integrimin e tyre.

BASHKËBISEDIMET ME PRINDËRIT

Të gjithë mësuesit do t'ju komunikojnë ditën kur ju mund ti takoni për të folur për fëmijën tuaj, për vështirësitë e tija dhe për përmirësimet në një bisedë individuale
Prindi ka edhe të drejtë të kërkojë një bisedim me mësuesit

Në qoftë se keni nevojë të flisni për fëmijën tuaj kërkonin menjëherë një bisedim me mësuesit

NETGRIMI I FËMIJËS TUAJ

Që të integrohet në klassën e re, të njohi shkollën dhe të gjejë një ndihmë në çastet e para, fëmija juaj do të jetë i shoqëruar nga një ndërmjetësues kulturor (mediatore culturale) që (pothuajse gjithmonë) flet gjuhën tuaj.

Zakonisht ndërmjetësi takohet edhe me familje.

Keni të drejtën ta kërkonin ju vetë takimin me ndërmjetësin

Përveç kësaj mësuesit do të organizojnë aktivitete individuale për fëmijën tuaj për mësimin e gjuhës italiane me shkrim dhe me gojë. Në disa shkolla ka mësues të specializuar për mësimin e gjuhës italiane fëmijëve të huaj

MBANI MEND!!!

Nëse keni ndonjë dyshim ose vështirësi mund ti drejtoheni gjithmonë për ndihmë mësuesit.

Përveç kësaj keni në dispozicion shumë shërbime për familjen:

- **Qendra e dokumentimit shumëkulturore Casa Delle Culture** e hapur nga e hëna në të martë nga ora 8.30 deri në 12.30 për të ndjekur kurse falas për të rritur për italisht, anglisht, informatikë;

- **Qendra ABABA** e hapur të martën dhe të Enjten nga ora 10,00 deri në 13.00 dhe të premten nga ora 14.30 deri në 17.00.Është një qendër për gratë e huaja dhe nënat me fëmijë të vegjël;
- **Emeroteka** me libra dhe gazeta nga vënde të ndryshme të botës.Është e hapur nga e hëna në të premte nga ora 8.30 deri në 12.30,të premten the të shtunen nga ora 15.00 deri në 18.00 dhe të djelën nga ora 16.00 deri në 19.00;
- **Qendra e argëtimit veror** për fëmijët nga 6 në 11 vjeç "Shkolla poshtë pemëve" hapur në muajin korrik dhe gusht.Për të ditur më shumë drejtohuni Casa Delle Culture;
- **Qendra e imigrantëve** e hapur të hënë,të mërkurën,të premten të enjten dhe të shtunën nga ora 9,15 deri në 13,15 dhe të martën nga ora 14,30 deri në 18.30
- **CTP**,qendra teritoriale për të edukimin e të rritur organizon kurse italisht falas.Për regjistrmin drejtohuni mësuesëve të hënë nga ora 17.00 deri në 19.00

Adresat dhe numrat e telefonit mund t'i gjeni ne librin telefonik te qytetit.

Teksti i shqyrtuar dhe adaptuar nga: COME-percorsi di
accoglienza, integrazione, educazione interculturale
Shtypi: Centro stampa del comune di Ravenna
Mundësuar nga: Casa delle culture
Piazza medaglie d'oro,4
48100 Ravenna
tel. 0544/591876
fax. 0544/423869
e-mail: casadelleculture@racine.ra.it
www.racine.ra.it/casadelleculture